



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA
SUPREME COURT OF REPUBLIC OF KOSOVO



Agj.nr. _____

Prishtinë

REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA E KOSOVËS	09.07.2015
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS		VRHOVNI SUD KOSOVA	
G.J.A-Su.A			219/2015
Dt:			10.07.2015
PRISHTINË - PRISTINA			

Kolegjiumi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, në Mbledhjen e Përgjithshme, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Rregullta, më 09.7.2015, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Ndryshohet qëndrimi parimor i kësaj Gjykate, Agj.nr. 314/2012, datë 10.09.2012, ashtu që konstatimi në arsyetimin e këtij qëndrimi, faqe 2. pasuesi 5.", se kur dënimi me gjobë zëvendësohet me dënim me burgim, afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit rrjedh nga koha kur aktvendimi ka marr formën e prerë *hiqet* dhe vendoset standardi i ri "Edhe në situatën kur gjykata me aktvendim ka zëvendësuar dënimin me gjobë me dënim me burgim, afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, llogaritet nga koha kur aktgjykimi mbi shqiptimin e dënimit me gjobë ka marr formën e prerë"

A r s y e t i m i

Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme, në Seancën e Përgjithshme të mbajtur më 10.09.2012, në arsyetimin e këtij qëndrimi konstatuar "kur dënimi me gjobë

zëvendësohet me dënim me burgim, afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit rrjedh nga koha kur aktvendimi ka marr formën e prerë”.


Konstatimi i tillë rezulton të jetë i gabuar dhe në kundërshtim me standardin.

Sipas nenit 110. të KPK-së, afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, e në rast se dënimi alternativ është revokuar, parashkrimi fillon nga dita kur vendimi mbi revokimin merr formën e prerë.

Dënimi me gjobë mund të shqiptohet si dënim kryesor apo si alternativ së bashku me dënimin me burgim, mirëpo në strukturën e dënimeve nuk i përket dënimit alternativ. Sipas nenit 49 të KPK-së, dënime alternative janë: Dënimi me kusht; gjysmë liria; dhe urdhri për punë në dobi të përgjithshme. Nga kjo qartë rezulton se afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit me gjobë fillon të rrjedhë nga momenti kur aktgjykimi mbi shqiptimin e këtij dënim ka marr formën e prerë, e jo nga momenti kur aktvendimi për zëvendësimin e këtij dënim me burgim ka marr formën e prerë, siç gabimisht është konstatuar me qëndrimin e mëparshëm parimor.

Nga arsyet e parashtruara u vendos që qëndrimi parimorë i datës 10.09.2012 , të ndryshohet.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës